

## AKT THEMELIMI

Sot ne dt.28/04/2025 me cilesine e "Ortakut te Vetem Themelues ",

**BEKIM HOTI** i datelindjes 15.04.1974, i lindur ne Dushanovë dhe banues ne Lagjia "Arbana" Rruga "Afrim Bytyçi" nr.49 Prizren,Kosove, shtetas KOSOVAR, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes nderkombetare me nr. P01284885 leshuar ne dt.03.10.2018 nga MPB,Republika e Kosoves,i cili me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ne ligjin "Per Qendren Kombetare te Biznesit", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijon shoqerine tregtare, me perjegjesi të kufizuar, me emertimin **BEHOTEK** shpk.

### KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

#### Neni 1

#### Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **BEHOTEK** shpk. Shoqeria do ti nenshtrohet legjislacionit Shqiptar.Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaku themelues.

#### Neni 2

#### Forma Juridike

Shoqeria **BEHOTEK** shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me perjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Biznesit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria **BEHOTEK** shpk, eshte nje e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortaku i vetem që përballon humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tij në kapitalin themeltar.

#### Neni 3

#### Selia

#### Shoqeria e ka seline ne adresen:

**Sarande, Rruga "Janaq Kumi" zk 6842,nr.pasurise 8/75-N1.**

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikes se Shqiperise, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

#### Neni 4

#### Objekti i veprimtarise

- **Investime ne pasuri te paluajtshme**
- **Ndertime te objekteve civile dhe industriale**
- **Sherbime te ndermjetesimit ne tregun e pasurive te paluajtshme**
- **Sherbime ne fushen elektrike,instalime,riparime.mirembajtje etj.**

#### Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB).

## KREU II

### KAPITALI

#### Neni 6

##### *Kapitali themeltar*

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000,000 lekë.

Kapitali i shoqerise eshte 10,000,000 leke i perbere nga 1 kuote dhe zoterohet nga ortaku i vetem i shoqerise Z.**BEKIM HOTI**

Vlera totale e Kapitalit te Regjistruar eshte **10,000,000 Leke**

Vlera Totale e Kapitalit prej **10,000,000 Leke** do te paguhet ne te ardhmen nga ortaku themelues.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Ortaku i vetem themelues perggjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

#### Neni 7

##### *Transferimi i kapitalit*

Pjesët e kapitalit themeltar mund tu transferohen personave të tretë që nuk bëjnë pjesë në shoqëri, vetëm me Vendim te Asamblese se Ortakut te vetem.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie. Ato janë lirisht të transferueshme edhe në rast ndarjeje pasurore mes bashkëshortëve. Gjithashtu janë të transferueshme ndërmjet bashkëshortëve, si dhe ndërmjet paraardhësve dhe pasardhësve.

## KREU II

### *ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE*

#### Neni 8

##### *Organi Vendimmarres*

Asambleja e Ortakut te vetem themelues eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Asambleja e Ortakut te vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e Ortakut te vetem brenda një afati prej gjashtë muajsh, duke filluar nga data e mbylljes së vitit finanziar, miraton raportin e administrimit, inventarin, bilancin dhe llogaritë vjetore, të hartuara nga administratori.

#### Neni 9

##### *Administrimi*

Shoqeria do te administrohet nga një administrator i vetem i cili do te jete:

**BEKIM HOTI** i datelindjes 15.04.1974, i lindur ne Dushanovë dhe banues ne Lagjia "Arbana" Rruga "Afrim Bytyçi" nr.49 Prizren,Kosove, shtetas KOSOVAR, madhor me zotesi juridike dhe per të vepruar, identifikuar sipas ligjit nepermjet Pasaportes nderkombetare me nr. P01284885 leshuar ne dt.03.10.2018 nga MPB,Republika e Kosoves.

Emerimi i administratorit eshte me një afat pese vjeçar me te drejte riemerimi, i cili ka te gjitha kompetencat per te kryer te gjitha veprimet e themelimit te shoqerise te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se ortakut te vetem te shoqerise.

#### Neni 10

##### *Kompetencat*

Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht Asamblese se ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerinë në marrëdhëni me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojet ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Klauzolat e ketij statuti që kufizojnë kompetencat e administratorit, të cilat rrjedhin nga ky nen, duhet të respektohen nga të tretët.

Administratori ose ortaku që nuk janë persona juridikë nuk u lejohet të kontraktojnë në çfarëdolloj forme qoftë, të marrin hua te shoqëria, të japin pëlqimin në emër të saj, për paradhënie si dhe të bëhen dorëzënës apo të garantojnë në emër të saj angazhimet ndaj të tretëve. Në rast të kundërt kontrata është e pavlefshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.

Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Regjistrin Tregtar Shqiptar dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe dhe per çfaredo shkaku, edhe para plotesimit të afatit per të cilin eshte kriuar siç mund të jene

- a.Humbja e kapitalit ose pamundesa e vazhdimit të metejshem të veprimtarise se saj.
- b.Ne nje nga menyrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin"
- c.Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Asambleja e Ortakut te vetem merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

#### Neni 13

##### Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plete me kete akt themelimi dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete akt themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil , Ligji per QKB, dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

#### Neni 14

##### Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne tre ekzemclare me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku i vetem themelues i shoqerise tregtare **BEHOTEK** shpk, nenshkruehet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tij orgjinale.

## **ORTAKU I VETËM I SHOQËRISE**

*BERIM HOTI*  
*[Signature]*